



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 1999/Prot
2

Elbasan më 30/04/2021

VENDIM
Nr. 38 datë 30 /04/2021

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike dhe pageses dyfishe nga fondi i kushtëzuar për muajin MARS 2021

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2021 "Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagese dyfishe nga fondet e kushtëzuara për muajin **MARS 2021** gjithsej 188 familje me një fond prej 1.152.136 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 1998 / Prot

Elbasan më 30 /04/2021

3

VENDIM

Nr. 39 datë 30 /04/2021.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin MARS 2021

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2021 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin MARS 110 familje me fond 342.500 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja





3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2033/prot.
11

Elbasan më 04.05/2021

VENDIM
Nr. 40 datë 30/04/2021

“Mbi shtyrjen e afatit të punonjësve me emërim të përkohshëm në arsimin parashkollor”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës...../...../2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore e Bashkisë mbi shtyrjen e afatit të punonjësve me emërim të përkohshëm në sistemin e arsimit parashkollor, përkatësisht 15 punonjëse sanitare si dhe 4 punonjës për dezinfektimin e objekteve arsimore; bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 54 të tij, Urdhërit nr.333, datë 20.05.2020 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratimin e Udhëzuesit të Institutit të Shëndetit Publik për “Masat ndaj Covid-19 që duhet të ndërmarrin institucionet e kopshteve dhe çerdheve”;

Vendosi

- 1- Shtyrjen e afatit të punonjësve me emërim të përkohshëm në arsimin parashkollor.
- 2- Ky afat do të shtyhet deri në përfundim të gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga covid-19.
- 3- Fondi i pagave dhe sigurimeve do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.
- 4- Ngarkohen Kryetari, Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Arsimit Parashkollor dhe Edukimit si dhe Qendra Ekonomike e Arsimit për zbatimin e këtij vendimi.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd GRIPSHI

KRYETAR

Hektor Ciftja

